



# TAKIMI XII I PËRBASHKËT I KP-E DHE KP-KRF të PULSAR- it, CFRR, BANKA BOTËRORE

Konsolidimi i pasqyrave financiare të sektorit publik:  
përfshirja e njësive të qeverisjes vendore dhe NSH-ve

11-13 nëntor 2025

## Përditësim mbi SEKSP-të

Peeter Leetmaa – Drejtues Ekipi, SEKSP  
Komisioni Evropian - EUROSTAT

# Direktiva për Kornizat Buxhetore (2011/85/BE)

Pas krizës financiare, Komisioni u përgjigj me të ashtuquajturën “Gjashtëshe”, përfshirë një direktivë e cila nuk kërkon të ketë sisteme të kontabilitetit publik me të drejta dhe detyrime të konstatuara pikë për pikë siç e kërkon ligji. Në fakt, është teknikisht e mundur, por e rëndë për të përmbushur qëllimin e ligjit duke pasur vetëm sisteme të kontabilitetit publik me bazë monetare.

Shtetet Anëtare duhet të kenë sisteme të kontabilitetit publik sipas Nenit 3, pika 1:

- të cilët të mbulojnë në mënyrë të plotë dhe të njëtrajtshme të gjithë nënsektorët e qeverisjes së përgjithshme
- të përmbajnë informacionet e nevojshme për të nxjerrë të dhëna me të drejta dhe detyrime të konstatuara me qëllim përgatitjen e të dhënave në bazë të standardit ESA
- objekt i kontrollit të brendshëm dhe auditimeve të pavarura



# Nisma për SEKSP-të

Nisma për Standardet Evropiane të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SEKSP) synon të sigurojë standarde të harmonizuara të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara të sektorit publik për BE-në, me një bazë të fortë për të kuptuar **pozicionin financiar dhe performancën** e njësive ekonomike qeveritare në të gjitha nivelet. Nisma nuk mbulon planifikimin buxhetor.

SEKSP-të synojnë:

- përmirësimin e **vendimmarrjes dhe llogaridhënies** mbështetur në dëshmi
- mbështetjen e hyrjes në **tregjet e kapitalit** dhe analizën e **financave publike**.
- sigurimin e një **burimi** më efikas të **dhënash** bazë për hartimin e statistikave dhe **zbutja e rreziqeve** për hartimin e tyre.

# Qasja aktuale e SEKSP-ve pas vitit 2015

Një qasje vullnetare dhe progresive:

- **Faza 1 (në proces): Rritja e transparencës në Shtetet Anëtare në periudhën afatshkurtër deri afatmesme përmes nxitjes së kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe paralelisht përgatitja e kuadrit të SEKSP-ve (që mbulon drejtimin e brendshëm, parimet kontabël dhe standardet).**
- **Faza 2 (në të ardhmen, pa një afat konkret): Trajtimi i krahasueshmërisë brenda dhe mes Shteteve Anëtare me anë të vënies në zbatim të SEKSP-ve.**

Raport-Progresi SWD 2019 => [lidhja](#)

Raport-Progresi SWD 2024 => [lidhja](#)

# Katër linjat e punës për SEKSP-të

- Komunikimi sistematik me palët e interesit
  - **Grupi i ekspertëve për SEKSP-të. Vendimmarrësit e politikave, qeveritë, audituesit, ekspertët e kontabilitetit, rrethet akademike, organizatat ndërkombëtare**
- Puna teknike që kontribuon në përgatitjen e SEKSP-ve
  - **Dokumente të publikimit të SEKSP-ve, shqyrtimi analitik i SNKSP-ve, udhëzues për zbatimin për herën e parë, Korniza Konceptuale i SEKSP-ve (versioni i rishikuar shkurt 2024), Struktura e SEKSP-ve**
- Puna për vlerësimin kosto-përfitim
  - **Studime të ndryshme, projekt-analizë e efektit**
- Mbështetje teknike dhe financiare për kontabilitetin e sektorit publik me të drejta dhe detyrime të konstatuara në Shtetet Anëtare
  - **Teknike: ndarja e praktikave më të mira etj.; financiare: grante për SEKSP-të, RRF, SRSP/TSI**

# Temat aktuale të SEKSP-ve

- Kohët e fundit, shumë vëmendje i është kushtuar Raportit të Komisionit për kontabilitetin publik në BE, që do të publikohet në dhjetor 2025
- Çështjet teknike të trajtuara në takimin e Grupit të Ekspertëve (GE) të SEKSP-ve në **nëntor 2024**: Materiale për publikimin e SEKSP-ve lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e transferimeve, ku trajtohen standardet e reja SNKSP 47 dhe SNKSP 48
- Çështjet teknike të trajtuara në takimin e GE të SEKSP-ve në **nëntor 2025**: paraqitja e pasqyrave financiare dhe trajtimi kontabël i pajisjeve ushtarake dhe shpenzimeve të lidhura me mbrojtjen në kuadër të BE-së
  - **Takimi i E-së në nëntor 2025 u parapri nga seminari ndërkombëtar “Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik”**
- Dokumentet gjenden në <https://ec.europa.eu/eurostat/web/epsas/>

# Trajtimi kontabël i pajisjeve ushtarake dhe shpenzimeve të lidhura me mbrojtjen në kuadër të BE-së

- Analizë gjithëpërfshirëse e trajtimit kontabël të aseteve ushtarake dhe shpenzimeve të lidhura me mbrojtjen sipas kornizave ndërkombëtare dhe kombëtare
- Lidhjet midis raportimit financiar dhe statistikor: Procedura e deficitit të tejkaluar (PDT) dhe monitorimi i shpenzimeve të mbrojtjes për NATO-n
- Qëllimi i fundmë është të sigurohet një bazë e fortë për të rritur njëtrajtshmërinë dhe besueshmërinë e informacioneve financiare për shpenzimet/aktivet ushtarake
- Prezantimi i DP ECFIN: trajtimi i shpenzimeve të mbrojtjes në kuadrin buxhetor të BE-së duke u përqendruar e shmangies nga rregullat
- Reforma e kontabilitetit në Greqi: shpenzime të larta ushtarake; klasifikimi i aktiveve dhe inventarëve ushtarakë; trajtimi i tanishëm/i ardhshëm i zërave ushtarakë; regjistrat e aktiveve dhe inventarëve; ndjeshmëria në paraqitje

# Ndryshimi i Direktivës së Kornizave Buxhetore dhe shqyrtimi i qeverisjes ekonomike të BE-së

Direktiva e Këshillit (BE) 2024/1265, datë 29.4.2024, për ndryshimin e Direktivës së kornizave buxhetore (2011/85/BE) i kërkon

- Komisionit Evropian të raportojë, brenda fundit të vitit 2025 dhe çdo pesë vjet pas kësaj date, mbi gjendjen e kontabilitetit publik të qeverisjes së përgjithshme në Bashkimin Evropian, duke marrë parasysh progresin pas analizës së përshtatshmërisë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik për Shtetet Anëtare në vitin 2013.

[Linku për Direktivën e Këshillit \(BE\) 2024/1265](#)

# Statusi aktual i raportit të Komisionit për kontabilitetin publik në BE

Raporti është në proces konfirmimi nga Komisioni; nuk është miratuar ende nga Komisioni (Kolegji).

Publikimi i raportit të Komisionit dhe dokumentit teknik të punës që e shoqëron atë, në dhjetor 2025

# Kapitujt e raportit të Komisionit për kontabilitetin publik në BE

1. Hyrje
2. Puna e Komisionit për modernizimin e kontabilitetit publik në BE
3. Arritjet dhe planet e Shteteve Anëtare në zhvillimin e kontabilitetit publik
4. Përshtatshmëria e SNKSP-ve për Shtetet Anëtare dhe përdorimi i mundshëm për SEKSP-të
5. Rruga për të ecur përpara për kontabilitetin publik në BE

## Kapitulli 3. Arritjet dhe planet e Shteteve Anëtare në zhvillimin e kontabilitetit publik

- Shumica e Shteteve Anëtare (14) përdorin tashmë kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara, 5 Shtete Anëtare do ta përdorin brenda vitit 2030. 8 Shtete Anëtare nuk planifikojnë të zbatojnë kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara në të gjithë sektorin e qeverisjes së përgjithshme brenda vitit 2030.
- Në mungesë të SEKSP-ve, të gjitha vendet reformuese kanë përdorur ose planifikojnë të përdorin SNKSP-të si bazë për zhvillimin e standardeve të tyre

# Reformat e kontabilitetit publik me të drejta dhe detyrime të konstatuara

- Reforma të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara janë në proces në Irlandë, Greqi, Kroaci, Itali, Qipro, Luksemburg, Portugali, Poloni dhe në dy shtete të Gjermanisë
- Vendet vijojnë të kërkojnë efikasitet dhe automatizim më të madh të procesit të raportimit financiar, për të pasur informacione më të mira si faktor hyrës për vendimmarrje më të mirë dhe harmonizim me evolucionin e SNKSP-ve.
- Përmirësimet e pritura të pjekurisë kontabël\* nga viti 2025 deri në vitin 2030:
  - **Greqia** nga 21% në 88%
  - **Italia** nga 32% në 88%
  - **Qiproja** nga 32% në 81%
  - **Luksemburgu** nga 43% në 69%
  - **Malta** nga 34% në 93%
  - **Portugalia** nga 63% në 83%

\* Në nivel të qeverisjes së përgjithshme

# Kapitulli 4. Përshtatshmëria e SNKSP-ve për Shtetet Anëtare dhe përdorimi i mundshëm për SEKSP-të

- Në këtë kapitull analizohet përshtatshmërinë e SNKSP-ve si kuadër i përbashkët i kontabilitetit publik në BE dhe përdorimi i mundshëm për zhvillimin e SEKSP-ve
- Kapitulli ka 3 pjesë: 1) Zhvillimi i SNKSP-ve pas vitit 2013, 2) Shqyrtimi analitik i standardeve SNKSP lidhur me përshtatshmërinë e tyre për zhvillimin e SEKSP-ve, 3) Rezultatet e anketës mbi përshtatshmërinë e SNKSP-ve për Shtetet Anëtare dhe përdorimin e mundshëm për zhvillimin e SEKSP-ve
- Dokumenti teknik i punës jep më shumë hollësi mbi zbatimin e SNKSP-ve nga Shtetet Anëtare të BE-së sipas fushave të kontabilitetit

**SHTOJCA 1. Pjekuria  
kontabël për çdo  
Shtet Anëtar dhe për  
çdo nënsektor të  
qeverisjes për vitin  
2025**

	Central	State	Local	Social	General Government
Belgium	79%	77%	73%	67%	74%
Bulgaria	76%		76%	70%	74%
Czechia	83%		83%	72%	81%
Denmark	81%		72%	72%	76%
Germany	22%	32%	62%	34%	35%
Estonia	91%		91%	89%	91%
Ireland	70%		79%	62%	70%
Greece	21%		38%	19%	21%
Spain	87%	85%	85%	67%	81%
France	88%		87%	92%	90%
Croatia	67%		68%	42%	61%
Italy	39%		39%	14%	32%
Cyprus	38%		85%	8%	32%
Latvia	92%		94%	88%	91%
Lithuania	88%		88%	78%	85%
Luxembourg	27%		32%	74%	43%
Hungary	66%		66%	56%	64%
Malta	33%		94%		34%
Netherlands	38%		58%	78%	53%
Austria	77%	77%	77%	61%	73%
Poland	71%		71%	58%	67%
Portugal	61%		70%	64%	63%
Romania	71%		71%	38%	64%
Slovenia	69%		69%	33%	58%
Slovakia	78%		78%	52%	70%
Finland	80%		85%	63%	77%
Sweden	83%		91%	71%	85%
Numerical average	66%	68%	73%	59%	

**SHTOJCA 2. Pjekuria  
kontabël për çdo  
Shtet Anëtar dhe për  
çdo nënsektor të  
qeverisjes për vitin  
2030 (parashikim)**

	Central	State	Local	Social	General Government
Belgium	79%	81%	73%	67%	76%
Bulgaria	77%		77%	70%	75%
Czechia	90%		90%	90%	90%
Denmark	81%		72%	72%	76%
Germany	22%	32%	62%	35%	35%
Estonia	91%		91%	89%	91%
Ireland	76%		79%	86%	77%
Greece	88%		95%	86%	88%
Spain	86%	85%	85%	70%	81%
France	88%		87%	92%	90%
Croatia	67%		70%	42%	61%
Italy	89%		89%	85%	88%
Cyprus	86%		93%	66%	81%
Latvia	92%		95%	88%	92%
Lithuania	89%		89%	78%	86%
Luxembourg	72%		31%	74%	69%
Hungary	66%		66%	56%	64%
Malta	93%		94%		93%
Netherlands	38%		58%	78%	53%
Austria	77%	77%	77%	61%	73%
Poland	71%		71%	58%	67%
Portugal	94%		70%	64%	83%
Romania	71%		71%	38%	64%
Slovenia	69%		69%	33%	58%
Slovakia	83%		83%	67%	79%
Finland	80%		85%	63%	77%
Sweden	83%		91%	71%	85%
Numerical average	78%	69%	78%	68%	

# Komunikimi

Komisioni Evropian – Eurostat – SEKSP:

<https://ec.europa.eu/eurostat/web/epsas/>

Arkiva CIRCABC:

<https://circabc.europa.eu/w/browse/18db61bc-6649-44b3-af14-17fcd1c1216c>

Qëndroni të informuar – ndiqni mediat sociale:



[@EU\\_Eurostat](https://twitter.com/EU_Eurostat)



[@EurostatStatistics](https://www.facebook.com/EurostatStatistics)



[@EU\\_Eurostat](https://www.instagram.com/EU_Eurostat)

# Faleminderit



Nëse nuk thuhet ndryshe, ripërdorimi i këtij prezantimi lejohet sipas lejes CC BY 4.0 .